

20101162241

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 31/98, 49/2003, 82/2005 dhe 24/2007), pas nenit 88 shtohen dy nene të reja neni 88-a dhe 88-b, si vijojnë:

"Neni 88-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton se është bërë parregullsi e cila në pajtim me këtë ligj është e përcaktuar si kundërvajtje nga neni 91 i këtij ligji, inspektori është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e bërë me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat të caktuar dhe me dorëzimin njëkohësisht të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia gjatë mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit i përcakton ministri i Kulturës.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Ministria e Kulturës, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të njëllojta për një ose më për shumë subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para organit kompetent.

(9) Ministria e Kulturës mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i Kulturës.

Neni 88-b

Ministria e Kulturës për kontrollet e kryera nga ana e inspektorëve përgatit raporte tremujore, të cilat publikohen në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës për shqyrtim të unifikuar tremujor."

Neni 2

Neni 91 ndryshohet si vijon:

"(1) Gjohë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- miraton akte në kundërshtim me këtë ligj (nenet 25 dhe 36),
- Ministrisë së Kulturës nuk i dorëzon të dhëna në pajtim me këtë ligj (neni 90) dhe
- nuk i harmonizon punën e vet dhe aktet me këtë ligj (neni 91).

(2) Gjohë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjohë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe tregtarit individual.

(4) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tri vite.

(5) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, tregtarit individual mund t'i shqiptohet edhe ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tri vite."

Neni 3

Pas nenit 91 shtohen tri nene të reja 91-a, 91-b dhe neni 91-v, si vijojnë:

"Neni 91-a

(1) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- kryen veprimtari në sferën e kulturës pa aktvendim se i plotëson kushtet për kryerjen e veprimtarisë (neni 22 paragrafi (2)),

- kryen veprimtari nga sfera e kulturës pa marrëveshje të lidhur me shoqatën kompetente (neni 57),

- pa dedikim i shfrytëzon mjetet e marra nga Ministria e Kulturës ose nuk dorëzon raport (neni 68 paragrafi (3)) dhe

- nuk i mundëson shikim inspektorit dhe nuk i ia jep të dhënat dhe njoftimet e kërkuara (neni 86 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 700 deri në 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 600 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe tregtarit individual.

(4) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet edhe ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tri vite.

(5) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, tregtarit individual mund t'i shqiptohet edhe ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tri vite.

Neni 91-b

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Ministria e Kulturës (në tekstin e mëtejshëm: Organi për kundërvajtje).

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 91-a të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

(3) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni para Organit për kundërvajtje, e udhëheq Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Kundërvajtje), i formuar nga ana e ministrit të Kulturës.

(4) Komisioni për Kundërvajtje përbëhet nga persona zyrtarë të autorizuar të punësuar në Ministrinë e Kulturës, prej të cilëve njëri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit për Kundërvajtje.

(5) Komisioni për Kundërvajtje përbëhet nga tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre, si vijojnë:

- dy juristë të diplomuar, nga të cilët njëri me provimin e dhënë të jurisprudencës me pesë vite përvojë pune në sferën e vet dhe

- një anëtar me përgatitje të lartë profesionale nga sfera e shkencave shoqërore me pesë vite përvojë pune në sferën e vet.

(6) Komisioni për Kundërvajtje zgjidhet në kohëzgjatje prej tre vitesh me të drejtë rizgjedhjeje të anëtarëve.

(7) Për kryetar të Komisionit për Kundërvajtje mund të zgjidhet vetëm juristi i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës.

(8) Komisioni për Kundërvajtje për Organin për kundërvajtje vendos për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër dhe shqipton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje ose me ligj tjetër.

(9) Krahas anëtarëve të Komisionit për Kundërvajtje, ministri i Kulturës mund të caktojë sekretar të Komisionit për Kundërvajtje i cili kryen punë administrative për Komisionin.

(10) Komisioni për Kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet.

(11) Kundër aktvendimeve të Komisionit për Kundërvajtje me të cilat shqiptohet sanksion për kundërvajtje, mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 91-v

(1) Për kundërvajtjet nga nenet 91 dhe 91-a të këtij ligji, inspektorët e kulturës janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të parashtrojnë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

(2) Inspektori i kulturës përpilon procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e gjendur në vendin e ngjarjes.

(3) Në procesverbal përcaktohet mënyra me të cilën do të mënjanohej pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.

(4) Inspektori i kulturës në procedurën për barazim kryerësit të kundërvajtjes i jep urdhërpagesë.

(5) Konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes me nënshkrimin e pranimi të urdhërpagesës pajtohet që ta paguajë gjobën.

(6) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e nënshkruan personi zyrtar, përkatësisht personi përgjegjës i cili është gjendur në vendin e ngjarjes gjatë mbikëqyrjes inspektuese, ose personi tjetër zyrtar ose personi përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë që ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) i këtij neni, regjistrohet në procesverbal.

(8) Inspektorët e kulturës janë të obliguar që të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për rezultatin e tyre."

Neni 4

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".